

Dhuna familjare – Plani për orë

Detyrat e nxënësve

- Të diskutohet për rolet e institucioneve që ofrojnë shërbime të mbrojtjes shëndetësore dhe shërbime të të drejtës penale për t'u ballafaquar me rastet e dhunës familjare.
- Të shihet përplasja ndërmjet të drejtës së vetëvendosjes dhe të drejtës së sigurisë në vendimet politike në lidhje me dhunën familjare.
- Të kuptohet dinamika e dhunës familjare, veçanërisht në raport me pabarazinë gjinore.
- Të studiohet se si vendet demokratike, që udhëhiqen nga këto principe, ballafaqohen me problemet e këtylla, e megjithatë arrijnë të zhvillojnë shumë zgjidhje të mundshme.
- Të analizohen shkaqet që e mbështetin dhe e kundërshtojnë pushtetin që ai t'ua diktojë institucioneve shëndetësore paraqitjen në polici të dëshmive për dhunën familjare.
- Të gjendet fusha të pajtueshmërisë dhe mospajtimit me nxënësit e tjerë.
- Të merret vendim, individualisht ose në mënyrë grupore, për atë se a duhet të kërkojë pushteti nga institucionet shëndetësore që t'i paraqesin dëshmitë e dhunës familjare në polici; të mbështeten vendimet e miratuara në bazë të dëshmive dhe të menduarit racional.
- Të mendohet në lidhje me vlerën e diskutimit të argumentuar kur merren vendime në lidhje me çështje të ndryshme në një demokraci.

Çështje për diskutim të argumentuar

A duhet t'ua diktojë demokracia jonë institucioneve shëndetësore që dëshmitë e dhunës familjare t'i paraqesin në polici?

Materialet

- Procedurat e orës
- Materiali nr. 1— Udhërrëfyese i diskutimeve të argumentuara
- Materiali nr. 2—Aktivitete për diskutime të argumentuara
- Materiali nr. 3—Qasja e nxënësve ndaj diskutimit të argumentuar
- Copa e leximit
- Burimet e zgjedhura
- Çështje për diskutim të argumentuar me argumente të parashtruara
(*zgjedhore – përdoreni nëse nxënësit e kanë vështirë t'i nxjerrin argumentet ose nëse koha është e kufizuar*)



Dhuna familjare – Copë leximi

1 Paramendoni se jeni në lidhje më ndonjë person të dhunshëm. Në çaste afekti, partneri juaj ju
2 godet. Goditjet e tij ju shkaktojnë lëndime në fytyrë. Dëshironi të shkoni në spital që të kërkonti
3 ndihmë mjekësore, por e dini se me ligj nga mjekët kërkohet që ta paraqesin këtë incident të
4 dhunshëm në polici. Mendoheni: a do ta pengojë paraqitja në polici maltretimin e mëtejshëm nëse
5 partneri/partnerja juaj do të paditet për dhunë? Dhe, a do të jetë shkak raporti i policisë edhe për
6 më shumë dhunë, ngase partneri/partnerja juaj pastaj do të dëshirojë t’u hakmerret?

7 Me qëllim që të mbrohet siguria personale e qytetarëve, shoqëritë demokratike e kanë
8 patjetër të ballafaqohen me këto dilema dhe të përpiqen ta pengojnë dhunën familjare. Meqë
9 “dhuna familjare i tejkalon të gjithë kufijtë dhe ndodhë në të gjitha kulturat” (Beban¹, 2003),
10 organet shtetërore nëpër gjithë botën zhvillojnë politika që t’i kundërvihen asaj. Diktimi i
11 institucioneve shëndetësore që ato ta paraqesin dhunën familjare në organet e pushtetit është
12 njëra nga strategjitë e propozuara. Miratimi i informuar i vendimit që është në favor ose kundër
13 paraqitjes së tillë të detyrueshme kërkon mirëkuptim nga fuqitë që janë të përfshira në dhunën
14 familjare.

15

16 **Dinamika e dhunës familjare**

17 “Vlerësohet se një nga pesë gra gjatë jetës së saj e përjeton një formë të dhunës, që në
18 disa raste kalon në lëndim ose vdekje.”

19 - Organizata Botërore Shëndetësore (C3O) ²,

20 *Ballafaqimi me dhunën ndaj femrave*

21 Dhuna familjare paraqet maltretim fizik, psikologjik ose seksual të partnerit të rritur
22 intim. Dhuna familjare dallohet nga format e tjera të dhunës, sepse ajo në mënyrë të pabarabartë i
23 prek femrat. Në Evropë, 25% e të gjitha rasteve të paraqitura të akteve kriminele përfshijnë burrë
24 që e ka sulmuar gruan ose partneren e tij (Komisioni Evropian, 2000). Përveç kësaj, udhëzimet e
25 një anketimi më të gjerë të grave dhe burrave që është realizuar në SHBA zbulojnë se tri herë më
26 shumë femra se meshkuj e shijojnë dhunën nga partneri i tyre intim (Tjaden dhe Ten³, 2000).

27 Kjo dhunë, që bazohet në dallimin gjinor, është një problem kompleks dhe
28 multidimensional (Beban, 2003). Njerëzit që nuk e kanë shijuar dhunën familjare mbase do t'i
29 akuzonin gratë pse qëndrojnë në lidhje të dhunshme. Megjithatë lidhjet intime shumë rrallë janë
30 të dhunshme që nga fillimi i tyre. Gratë më shpesh ushqejnë dashuri ndaj partnerëve të tyre para
31 se të fillojë maltretime. Pos kësaj, lidhjet e dhunshme nuk janë vazhdimisht të dhunshme.
32 “Dhunuesit me sukses arrijnë ta ndërthurin intimitetin dhe maltretime që ashtu t'i kontrollojnë
33 partnerët e tyre” (Koalicioni i Misurit kundër dhunës familjare dhe gjinore, 2006).

34 Me rëndësi është se numri më i madh i grave që kanë përjetuar dhunë familjare në fakt
35 është shprehje e pabarazisë së rrënjosur ndërmjet gjinive (OSHB, 2005). Fondi zhvillimor i
36 Kombeve të Bashkuara për çështjet femrave i përcakton pabarazitë në fuqi ndërmjet femrave dhe

¹ Beban

² World Health Organization (WHO)

37 meshkujve si burim parësor të dhunës ndaj femrave. Normat familjare, shkollat dhe vendet e
38 punës e fuqizojnë bindjen se femrat janë më inferiore në krahasim me meshkujt, femrat janë të
39 lëndueshme nga dhuna (UNIFEM, 2001). Prandaj organizatat që punojnë në çrrënjosjen e dhunës
40 familjare koncentrohen në ndryshimin e formave të mashkullorësisë që nxisin dhunë. Një
41 program me të rinj të Bosnjës, Kroacisë, Malit të Zi dhe Serbisë, për shembull, u përpoq t'u
42 ndihmojë këtyre meshkujve të rinj që të krijojnë identitet mashkullor që i mbështet raportet e
43 pabarabarta dhe raportet me femrat që janë të bazuara në respekt (Ekmen⁴ etj, 2007).

44 Varfëria, luftërat dhe mungesa e arsimit formal te femrat po ashtu lidhet me dhunën
45 familjare (OBSH, 2005). Meshkujt që nuk janë të punësuar ose që kanë pak siguri në punë mund
46 të jenë të dhunshëm për shkak të frustrimit dhe ndjenjës së pashpresës. Përveç që meshkujt e
47 përdorin dhunimin dhe dhunën gjinore kundër femrave si mjet lufte, meshkujt në kombet që janë
48 të prekur nga lufta mund ta humbin statusin e tyre si prijës dhe mbrojtës të familjes. “Stresi,
49 ndjenjat e paaftësisë dhe vetërespektit të paktë te meshkujt” në situata të këtilla e rrisin
50 “mundësinë për të bërë dhunë” (Ekmen etj, 2007).

51 Po ashtu është më shumë e mundshme që femrat me arsimim më të paktë ta shijojnë dhunën
52 familjare sesa femrat me nivel të lartë të arsimimit. Ndonëse “disa meshkuj dinë të reagojnë në
53 mënyrë të dhunshme kundër pikëllimit të femrave përmes arsimit”, kur mjaft femra të kenë nivel
54 të lartë të arsimimi, ato zhvillojnë “vetëbesim më të madh, rrjete më të gjera sociale dhe aftësi
55 më të madhe që t'i përdorin informacionet dhe resurset” (OBSH, 2005). Ky pikëllim mund t'i
56 zhvendosë rolet tradicionale gjinore dhe t'u mundësojë femrave të arrijnë pavarësi ekonomike që

³ Tjaden & Thoennes

⁴ Eckman et al.

57 pastaj shpijnë drejt barazisë më të madhe gjinore dhe, si rezultat i kësaj, më pak dhunë e bazuar
58 në dallimet gjinore.

59

60 **Roli i diskutueshëm i paraqitjes së detyrueshme**

61 Natyra komplekse e dhunës familjare shumë njerëz i nxit të thonë se edhe zgjidhjet e saj
62 patjetër duhet të jenë komplekse. Kështu disa zëdhënës thonë se përgjigjja e koordinuar e
63 bashkësisë është mënyra e mirë që viktima të sigurohet, ndërsa dhunuesit të nxirren para
64 drejtësisë. Kjo përgjigje e koordinuar përfshin “agjenci për zbatimin e ligjeve, avokatë,
65 institucione shëndetësore, institucione sociale për mbrojtjen e fëmijëve, firma lokale, media,
66 punëdhënës dhe klerikë (“Ndaleni dhunën kundër femrave, 2006).

67 Ndërkaq të tjerët thonë se nxitja e institucioneve shëndetësore që ta paraqesin dhunën
68 familjare në organet gjegjëse është më e kufizuar, por njëherazi një ilaç kurues i dhunës
69 familjare. Mbështetësit e paraqitjes së detyrueshme të dhunës familjare e shikojnë këtë si çështje
70 që është e lidhur me kriminalitetin dhe shëndetin, andaj kërkojnë që policia dhe institucionet
71 shëndetësore bashkërisht të punojnë në zgjidhjen e saj. Ata thonë se përfshirja e institucioneve
72 shëndetësore në procesin e raportimit do të ndihmojë që mjekët të sigurohen që ta kuptojnë
73 dinamikën e dhunës familjare. Mjekët që do të stërviten për dhunën familjare do të kenë më
74 shumë vetëdije për këtë temë, ashtu që do të mund t’i zbulojnë dhe shërojnë lëndimet që janë të
75 lidhura me të (Koalicioni kundër dhunës familjare në Kolorado, 2006)

76 Ata që e shohin sigurinë e viktimave si përparësinë e parë në përgjigjen e tyre ndaj dhunës
77 familjare shumë shpesh e kundërshtojnë paraqitjen e detyrueshme. Sipas Komisionit të të
78 Drejtave të Njeriut, kulturat policore në shumë vende shfaqin qëndrime diskriminuese ndaj

79 femrave në përgjithësi dhe, në veçanti, ndaj femrave që janë viktime të dhunës familjare
80 (Kumarasvami⁵, 1997). Prandaj femrat shpesh nuk u besojnë policëve dhe nuk dëshirojnë të
81 paraqiten te ato organe. “Nëse [viktimat] frikohen se paraqitja do t’i vë ata dhe fëmijët e tyre në
82 rrezik akoma më të madh, [ata] mund të kërkojnë ndihmë mjekësore ose mund të mos u tregojnë
83 mjekëve të tyre amë për dhunën (Hajman⁶, 1997). Kur viktimat i shmangen trajtimit mjekësor,
84 sepse nuk i besojnë policisë dhe/ose frikohen nga hakmarrja e dhunuesve të tyre pse i kanë
85 përfshirë në rastin e tyre organet shtetërore, ata shpesh nuk arrijnë ta marrin përkujdesjen dhe
86 resurset – si për shembull: këshillim, strehim dhe shërbime juridike – që u nevojiten për ta
87 penguar maltretimin e tyre në të ardhmen.

88 Disa punonjës shëndetësorë thonë se paraqitja e detyrueshme e zvogëlon aftësinë e tyre për të
89 ofruar ndërhyrje që mundësojnë ndryshim në rastet e dhunës familjare. Nëse viktimat e fshehin
90 situatën e dhunshme nga punonjësit shëndetësorë, kjo me qëllim që të shmanget paraqitja e
91 detyrueshme, punonjësit shëndetësorë nuk mund t’u rekomandojnë resurse gjegjëse dhe
92 shërbime të mundshme. Disa punonjës shëndetësorë po ashtu e kuptojnë paraqitjen e
93 detyrueshme si shkelje të besimit ndërmjet punëtorit shëndetësor dhe pacientit. Nëse pacientët
94 nuk dëshirojnë që incidentet e dhunës të paraqiten, shumë punonjës shëndetësorë dëshirojnë ta
95 respektojnë këtë vendim. Nëse hyn në fuqi paraqitja e detyrueshme, punonjësit shëndetësorë do
96 ta shkelnin ligjin nëse do të refuzonin t’i paraqesin incidentet e dhunës familjare (Kombet e
97 Bashkuara, 2006; Shoqata e Shëndetit të Femrave dhe Motrave Medicinale që punojnë në
98 shtëpitë e lindjes, 2007).

⁵ Coomaraswamy

⁶ Hyman

99 Mbështetësit e paraqitjes së detyrueshme thonë se meqë shumë viktime nuk paraqiten në
100 polici, organet e kanë vështirë ta vlerësojnë shpeshtësinë dhe shkallën e dhunës familjare. Pa
101 pasur një statistikë të saktë për problemin, ata që i miratojnë vendimet e kanë vështirë t'i
102 përfitojnë resurset dhe mbështetjen e nevojshme që është e nevojshme që t'u ndihmohet
103 viktimave dhe që të krijojnë programe që do të kenë ndikim për ta penguar dhunën. Paraqitja e
104 detyrueshme nga institucionet shëndetësore mund t'u ndihmojë organeve që më mirë t'i
105 dokumentojnë incidentet e dhunës familjare që u ndodhin qytetarëve të tyre (Ndaleni dhunën
106 kundër femrave, 2006) Me një përcaktim më preciz të problemit, organet mund ta trajtojnë
107 dhunën familjare si çështje të fushës së politikës publike që urgjentisht meriton vëmendje dhe
108 kërkon zgjidhje.

109 Mbështetësit po ashtu insistojnë se paraqitja e detyrueshme u mundëson organeve shtetërore
110 që t'i gjejnë dhunuesit. Nëse viktimat nuk e paraqesin dhunës në shërbimet e sigurisë ose në
111 agjencitë e mbrojtjes sociale, organet nuk kanë mundësi t'i paditin ata që kryejnë dhunë
112 familjare. Nga ana tjetër, kur institucionet shëndetësore i paraqesin incidentet e dhunshme,
113 sistemi juridik penal mund t'i sigurojë mbrojtje viktimës. Përveç kësaj, dëshmitë e maltretim
114 që do t'i vërejnë institucionet shëndetësore në dosjet medicinale të viktimave mund të përdoren
115 në paditjen dhe gjykimin e dhunuesve të zbuluar.

116 Ata që i kundërvihen paraqitjes së detyrueshme thonë se kjo do t'ua shkurtojë viktimave të
117 drejtën që vetë të marrin vendime në momentet kritike të jetës. Me faktin që viktimave nuk u
118 lejohet të vendosin se a dëshirojnë ta paraqesin maltretim, paraqitja e detyrueshme "i përforcon
119 stereotipat e dëmshëm se femrat e maltretuara janë pasive dhe të pandihma (Hajman, 1997).

120 Mbështetësit e paraqitjes së detyrueshme thonë se ajo e rrit sigurinë e viktimës përmes
121 trajtimit të dhunës familjare si akt kriminel të sulmit dhe keqpërdorimit, përkundër pohimit se ajo

122 është “çështje familjare” (Seçe⁷, 2000). Që dhuna familjare të eliminohet, organet duhet ta
123 informojnë opinionin e gjerë se ajo është vepër penale serioze që nuk guxon të injorohet”
124 (Koalicioni kundër dhunës familjare në Kolorado, 2006)

125 Aktivistja e të drejtave të njeriut, Sharlot Banç⁸ thotë se: “Asgjë nuk është e pandryshueshme
126 në lidhje me keqpërdorimin e dhunshëm të femrave dhe vajzave... Por, meqë kjo është aq thellë
127 dhe aq gjatë e rrënjosur në secilën kulturë aktuale të Tokës, përpjekja që të bashkohen strukturat
128 shoqërore që e tolerojnë ose që refuzojnë hapur ta pranojnë, do të kërkojë kreativitet, durim dhe
129 veprim në shumë fronte.”

⁷ Sachs

⁸ Charlotte Bunch



Dhuna familjare – Burimet e zgjedhura

Shoqata e Shëndetit të Femrave dhe Motrave Medicinale që punojnë në shtëpitë e lindjes, *Paraqitja e detyrueshme e dhunës nga partneri intim* (Uashington, D.C. AWHONN, 2007),
http://www.awhonn.org/awhonn/binary.content.do;jsessionid=CB320B57897F5C93C5A4152FB03D5F40?name=Resources/Documents/pdf/5H1_PS_IntimatePartnerViolence.pdf.

Bena, Adriana, *Dhuna familjare ndaj femrave në Shqipëri*, (Nju-Jork: UNICEF, 2003),
http://www.unicef.org/albania/domviol_eng.pdf.

Banç Sharlot, “Status quoja e paduruar: Dhuna ndaj grave dhe vajzave”, në *Progresi i kombeve 45*, (Nju-Jork: UNICEF, 1997), <http://www.unicef.org/pon97/40-49.pdf>.

Koalicioni kundër dhunës familjare në Kolorado, *Paraqitja e detyrueshme nga institucionet shëndetësore* (Denver, Kolorado: CCADV, 2006),
<http://www.ccadv.org/publications/CCADVMandatoryReportingIssueBrief.pdf>.

Kumurasvami Radika, *Raporti i raportuesit special për dhunën ndaj grave, pasojat dhe shkaqet e saj* (Gjenevë, Zvicër, Zyra e Komisaritit të lartë për të drejtat e njeriut në Kombet e Bashkuara, 1997),
<http://www.unhchr.ch/Huridocda/Huridoca.nsf/0/043c76f98a706362802566b1005e9219?Opendocument>.

Ekman, En etj., *Hulumtimi i dimensioneve të maskullorësisë dhe dhunës* (Uashington, D.C. Qendra ndërkombëtare për hulumtimin dhe përkujdesjen e grave, 2007)
http://www.wavenetwork.org/images/doku/balkan_gender_based_violence_report.pdf.

Komisioni Evropian, “Fushata evropiane për ngritjen e vetëdijes për dhunën ndaj grave”, (2000),
http://ec.europa.eu/employment_social/equ_opp/violence_en.html.

Hajman Ariela, *Paraqitja e detyrueshme e dhunës familjare nga institucionet shëndetësore*, (San Francisko, Kaliforni: Fondi për pengimin e dhunës familjare, 1997),
<http://www.endabuse.org/health/mandatoryreporting/policypaper.pdf>.

Koalicioni i Misurit kundër dhunës familjare dhe gjinore, *Korniza e mirëkuptimit të dinamikës së dhunës familjare* (Xheferson Siti, Misuri, MCADSV),
<http://www.mocadsv.org/Resources/CMSResources//pdf/dv101.pdf>.

Seçs Kerolin, “A duhet të kërkohet nga mjekët që ta paraqesin dhunën familjare në polici?” (2000), *Zhurnali perëndimor i medicinës (Western Journal of Medicine)* 173 (4):225.

Ndalen dhunën kundër grave (Mineapolis: Zëdhënësit e të drejtave të njeriut në Minesota, 2006),
<http://www.stopvaw.org>.

Tjaden, Patrisha dhe Nesni Ten, *Shkalla, natyra dhe pasojat e dhunës nga partneri intim: Udhëzimet e anketës nacionale për dhunë ndaj grave*, (Uashington, D.C: Ministria e Drejtësisë së SHBA-ve, 2002, www.ncjrs.gov/txtfiles1/nij/181867.txt).

UNIFEM, “Mashkullorësia dhe dhuna e bazuar në dallimet gjinore”, *Buletini i gjinive i UNIFEM-it nr. 5* (Bankok, Tajlandë: Zyra rajonale e UNIFEM-it për Azinë Lindore dhe Juglindore, 2001), <http://unifem-eseasia.org/resources/factsheets/UNIFEMSheet5.doc>.

Kombet e Bashkuara, *Studim i Sekretarit të Përgjithshëm për dhunë ndaj femrave* (Nju-Jork, Reparti i OKB-së për avancimin e femrave, 2006), <http://www.un.org/womenwatch/daw/vaw/violenceagainstwomenstudydoc.pdf>.

Organizata Botërore Shëndetësore, *Pengimi i dhunës ndaj femrave dhe realizimi i qëllimeve zhvillimore mijëvjeçare* (Gjenevë, Zvicër, Reparti i OSHB-së për punën me mediat, 2005) <http://www.who.int/gender/documents/MDGs&VAWSept05.pdf>.



Dhuna familjare – Çështje për diskutim të argumentuar me argumente të parashtruara

Çështje për diskutim të argumentuar

A duhet t'u diktojë demokracia jonë institucioneve shëndetësore që t'i paraqesin dëshmitë e dhunës familjare në polici?

Argumente për kundërshtimin e çështjes për diskutim të argumentuar

1. Dhuna familjare është çështje e ndërlikuar edhe me kriminalitetin edhe me shëndetin. Prandaj zgjidhjet e dhunës familjare patjetër duhet t'i përfshijnë institucionet shëndetësore. Paraqitja e detyrueshme i inkurajon punonjësit shëndetësorë që të bashkëpunojnë me policinë, gjë që shpie drejt një përgjigje më efektive ndaj dhunës në shtëpi.
2. Inkuadrimi i institucioneve shëndetësore në procesin e paraqitjes ndihmon që të sigurohet se mjekët e kuptojnë dinamikën e dhunës familjare. Mjekët që do të stërviten për dhunën familjare do të kenë më shumë vetëdije për këtë temë, ashtu që do të mund t'i zbulojnë dhe shërojnë lëndimet që janë të lidhura me të.
3. Organet duhet të kenë mundësi ta vlerësojnë saktë shpeshësinë dhe shkallën e dhunës familjare nëse dëshirojnë që ta trajtojnë dhunën familjare si çështje të fushës së politikës publike që meriton vëmendje dhe që kërkon zgjidhje urgjente. Meqë shumë viktime nuk paraqiten në polici, organet e kanë vështirë t'i dokumentojnë incidentet e dhunës familjare. Paraqitja e detyrueshme nga institucionet shëndetësore mund t'u ndihmojë organeve që ta zbulojnë këtë çështje më saktë me qëllim që të mund t'i mobilizojnë resurset dhe mbështetjen publike që nevojiten për të luftuar kundër saj.
4. Paraqitja e detyrueshme u mundëson organeve që t'i zbulojnë dhunuesit. Kur institucionet shëndetësore t'i paraqesin incidentet e dhunshme, sistemi juridik penal mund t'i sigurojë viktimës mbrojtje. Dëshmitë e maltretimave që do t'i vërejnë institucionet shëndetësore në dosjet medicinale të viktimave mund të përdoren në paditjen dhe gjykimin e dhunuesve të zbuluar.
5. Paraqitja e detyrueshme e rrit sigurinë e viktimës përmes trajtimit të dhunës familjare si akt kriminel të sulmit dhe keqpërdorimit, përkundër pohimit se ajo është “çështje familjare”. Ky trajtim e përcjell mesazhin se dhuna familjare është vepër penale serioze që nuk do të injorohet nga pushteti.



Dhuna familjare – Çështje për diskutim të argumentuar me argumente të parashtruara

Çështje për diskutim të argumentuar

A duhet t'u diktojë demokracia jonë institucioneve shëndetësore që t'i paraqesin dëshmitë e dhunës familjare në polici?

Argumente për kundërshtimin e çështjes për diskutim të argumentuar

1. Dhuna familjare është një problem kompleks që kërkon zgjidhje komplekse. Ndonëse paraqitja e detyrueshme i përfshin institucionet shëndetësore dhe institucionet që ofrojnë shërbime juridike-penale, ajo nuk nxit edhe përgjigje të koordinuar të bashkësisë për dhunën familjare. Kjo përgjigje kërkon pjesëmarrje plotësuesve të avokatëve, punëtorëve socialë për mbrojtjen e fëmijëve, firmave lokale, mediave, punëdhënësve dhe klerikëve.
2. Ndonëse mbështetësit e paraqitjes së detyrueshme kanë qëllime të mira, miratimi i një vendimi të tillë nuk është mënyrë efektive që të ruhet siguria e viktimave. Shumica e viktimave të dhunës familjare janë femra, ndërsa shumica e kulturave policore shfaqin qëndrime diskriminuese ndaj femrave në përgjithësi. Prandaj femrat shpesh nuk u besojnë policëve dhe nuk dëshirojnë ta paraqesin dhunën familjare atë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi. Nëse viktimat vendosin se paraqitja nga institucionet shëndetësore do t'i vë ata në rrezik më të madh, ata mund të mos kërkojnë ndihmë mjekësore për lëndimet e tyre.
3. Paraqitja e detyrueshme e zvogëlon aftësinë e punëtorëve shëndetësorë për të ofruar ndërhyrje që kanë ndikim për rastet e dhunës familjare. Nëse viktimat e fshehin situatën e dhunshme nga punonjësit shëndetësorë me qëllim që kështu të shmangët paraqitja e detyrueshme, punonjësit shëndetësorë nuk mund t'u rekomandojnë resurse gjegjëse dhe shërbime të mundshme.
4. Paraqitja e detyrueshme e rrënon besueshmërinë ndërmjet punonjësit shëndetësor dhe pacientit. Nëse pacientët nuk dëshirojnë t'i paraqesin incidentet e dhunës, shumë punonjës shëndetësorë dëshirojnë ta respektojnë atë vendim. Refuzimi etik i paraqitjes së detyrueshme e shndërron dhunën familjare në shkelje të ligjit.
5. Viktimat janë njerëz të rritur autonomë që kanë të drejtë vetë të sjellin vendime në momentet kritike të jetës. Me faktin që viktimave nuk u lejohet të vendosin se a dëshirojnë ta paraqesin maltretimin, paraqitja e detyrueshme “i përforcon stereotipat e dëmshëm se femrat e maltretuara janë pasive dhe të pandihma” (Hajman, 1997).